



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.365/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Elton Xhemajli, kandidat për anëtar në kuvendin e Komunës së Pejës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të parashtruara kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 31.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Hedhet e pasafatshme ankesat e parashtruara nga Elton Xhemajli, kandidat për anëtar në kuvendin e Komunës së Pejës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ZL.Anr.365/2025 dhe 366/2025 të datës 29.10.2025, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 29.10.2025, ka pranuar ankesat ZL.Anr.365/2025, dhe ZL.Anr.366/2025 të dorëzuara përmes postës me datë 24.10.2025, nga Elton Xhemajli, kandidat për anëtar në kuvendin e Komunës së Pejës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR), me të cilat pretendon se gjatë procesit të numërimit të votave është vërejtur se votat e tij nuk janë pasqyruar në mënyrë të saktë në rezultatet preliminare të publikuara nga KQZ. Dyshohet për gabim teknik ose mos përfshirje të votave gjatë procesit të regjistrimit apo numërimit, përkatësisht në vendvotimet 1717 dhe 1704. Ka kërkuar nga PZAP rinumërim të vendvotimeve të lartcekura. Ka bashkangjitur kopje të letërnjoftimeve të disa përsoanave për cilët pretendon se e kanë votuar.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 30.10.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), kanë deklaruar se bazuar në nenin 101 të LZP-së Nr.08/L-228, Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Andaj bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore, në nenin 9 paragrafi 1 thekson se në rastet të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të

Numërimin, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Sa i përket pretendimit të palës se mungojnë i mungojnë votat e votuesve të cilët sipas deklaramentit të tyre e kanë votuar, theksojnë se ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, nuk mund të identifikohet mënyra e votimit të asnjë votuesi. Pretendimet e palës të cilat mbështeten në pritshmërinë dhe deklaramentet e personave se kanë votuar për ta, duhet theksuar se në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Në përgjigje në ankesë kanë theksuar se ankesa është paraqitur pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, pasi sipas konfirmimit të ZEKKZ-ve vërehet se aktiviteti i QKN në Pejë është përmbyllur me datë 17.10.2025, ndërsa pala ankuese, ankesat i ka parashtruar me postë me datë 24.10.2025, pra, ankesat nuk janë paraqitur brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, pala ankues nuk ka bashkangjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tyre.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar dy ankesat ZL.Anr.365/2025 dhe ZL.Anr.366/2025 të datës 29.10.2025, të paraqitura nga Elton Xhemajli, kandidat për asamble komunale në Komunën e Pejës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me numrat e ankesave si më lartë dhe të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohet nën shenjën e përbashkët ZL.Anr.365/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës vëren se ankesa është e pasafatshme

Në këtë rast, PZAP nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, ankesës së ankuesit, përgjigjen në ankesë të KQZ-së vërtetohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 24.10.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi në numërim të votave, ndërsa sipas përgjigjes nga KQZ dhe provave të bashkangjitura procesi i numërimit në Qendër Komunale është përmbyllur me datë 17.10.2025.

Sipas Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nenit 105 paragrafi 1, përcaktohet se *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.”*

Po ashtu sipas nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, përcaktohet se *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara.”* Ndërsa neni 13 paragrafi 3, i të njëjtës rregullore përcakton se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.”*

PZAP vëren se nga përgjigja e KQZ dhe provave të bashkangjitura të nëjtës është vërtetuar fakti se aktiviteti i QKN-së në Komunën e Gjilanit, është përmbyllur më datë 17.10.2025, kurse ankuesi ankesën e ka parashtruar në PZAP më datë 24.10.2025, me çka vërtetohet se ankesat e ankuesit nuk janë paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 105 paragraf 1 i LZP-së, nenit 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 9 paragrafi 5, nenin 13, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës Nr.1/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.365/2025, datë 31.10.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.